

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

THIRD PILLAR RECRUITING-TPR SH.P.K.

Sot, më datë 15/11/2021

**Salomon D HARARI**, atesia David, amesia Leah, shtetas Amerikan, lindur ne New York, SHBA me date 03/12/1987, banues ne SHBA, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, i pajisur me me Pasaporte Amerikane Nr. 524332272.

ka përpiluar këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **THIRD PILLAR RECRUITING - TPR SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare **THIRD PILLAR RECRUITING - TPR SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **THIRD PILLAR RECRUITING - TPR SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit te saj:

Ndermjetesim ne tregun e punes brenda dhe jashte vendit. Agjenci punesimi.

Ofrimin e sherbimit të asistences dhe konsulencës ne fusha te ndryshme, kontraktuale, ekonomike, administrative, financiare, biznesore, menaxheriale, dhe të drejtimit përsipërmarrjet, ne sistemet e informacionit dhe marketing, ndërmjetësim tregtar, studim e kerkim tregu, aktivitetet e asistencës dhe konsulencës për menaxhimin e logistikës së ndërmarrjes; aktivitetet e formimit përfshi punësuarit, administratorët, drejtuesit e sipërmarrësit, zhvillimit të trajnimeve e kurseve të formimit profesional .

Zhvillimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e teknologjise se informacionit, te networkut dhe gjithçka qe ka te beje me boten e informatikes dhe internetit; zhvillim software dhe aplikime multimediale. Realizimin dhe mirembajtjen e faqeve web, realizimin dhe regjistrimin e domeineve, mbledhjen, ndermjetesimin, shitjen dhe publikimin e hapesirave publicitare on-line,



realizimin e sherbimeve te grafikes publicitare dhe, ne per gjithsesi, te gjithkaje qe ka lidhje me kurimin e koordinuar te imazhit nga sipermarrjet.

Aktivitet në sektorin imobiliar të menaxhimit, blerjes, shitjes, shkëmbimit, tregtisë, qirasë, vlerësimit të pasurive të paluajtëshme të çfarëdo lloj natyre. Agjenci imobiliare.

Tregti me shumice e pakice artikuj te ndryshem industriale .

Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqeria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqeri të tjera, konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngjashem apo analoge me te vetin dhe te kryeje te gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Ne vecanti, shoqeria, mund te marre ne pronesi, uzufruktose ose qera, kompani ose dege kompanish qe operojne ne fushen e nje ose me shume prej veprimtarive te mesiperme.

#### NENI 4

##### Kapitali i Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

Tirane, Rruga "Sali Butka", ZK 8250, Godina nr.pasurie 1/59+1-44, Kati II-te.

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100.000 Leke (njeqindmije) lekë dhe përbhet nga 1 (nje) kuote.

**Z. Salomon D HARARI** është zotërues e 1 kuote, me 100 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000 leke.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet **për një afat 5 vjecar**, me te drejte



riemerimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë Znj. Armela KAPE, atesia Ylli, amesia Luljeta, e dli. 16/06/2000, e pajisur me Karte identiteti me ID 033645988 dhe Nr. personal K05616066B.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar përfajtje të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### NENI 11

##### Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqerise. Cdo gjë që nuk ështe parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

#### ORTAKU THEMELUES

SALOMON HARI  
Salomon D. H.

EKATERINA STRATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER FLORIAN F. HOXHA



DATE 15/11/2021  
NR REP 1646

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15.11. 2021(Dymije e njezet e nje), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUUES/IT:

SALOMON D HARARI, atësia DAVID, amësia LEAH, shtetas Amerikan, lindur në NEW YORK dhe banues në NEW YORK, me adresë New York Amerike, lindur më 03/12/1987, gjendja civile " i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Tjeter nr. 524332272 dhe nr. personal 524332272.

Shtetasi i mesiperm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruajti përpara meje Noterit, ne prezencë te perkthyeses se licensuar te gjuhes Angleze Ekaterina Strati "Akt-Themelin e Shoqerise THIRD PILLAR RECRUITING - TPR shpk.", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

FLORIAN F. HOXHA

perkthyesë  
Ekaterina Strati

EKATERINA STRATI

